

Deklaratë për mediat

Zgjedhjet për kryetarin e Partisë Demokratike janë të hapura dhe çdo anëtar i Partisë Demokratike ka të drejtë të kandidojë. Kjo garë do të jetë një mundësi e jashtëzakonshme për reflektim, diskutim idesh dhe konkurrencë vizionesh për të ardhmen e Partisë Demokratike dhe demokracisë në vend.

Mendimi ndryshe, debati dhe përplasja e ideve janë vlera themelore të Partisë Demokratike. Por diskutimet duhet të zhvillohen në mënyrë reflektive, të qytetëruar dhe etike duke respektuar të drejtën dhe dinjitetin e gjithkujt, përmes frymës së bashkimit dhe gjithëpërfshirjes dhe jo përcarjes e përjashtimit.

Ndryshimet në qëndrime dhe në mendime në Partinë Demokratike zgjidhen vetëm përmes konkurrencës së kandidatëve dhe vendim-marrjes së anëtarëve.

Në lidhje me çdo pretendim, Statuti i Partisë Demokratike përcakton:

Neni 43, pika 1 dhe 2

Nënkryetarët e Partisë:

- 1. PDSH ka dy Nënkryetarë të cilët zgjidhen sipas përcaktimeve të Nenit 37 të Statutit*
- 2. Në mungesë të zgjatur të Kryetarit dhe me autorizim të tij, njëri prej tyre zëvendëson Kryetarin. Në mungesë të këtij autorizimi (dorëheqje, etj.) Sekretari i Përgjithshëm mbledh Këshillin Kombëtar i cili komandon Nënkryetarin që do të drejtojë Partinë deri në vendimin përfundimtar të Kuvendit Kombëtar.*

Neni 58

Afati i Zgjedhjeve:

Të gjitha organet e Partisë duhet tu nenshtrohen zgjedhjeve të paktën çdo katër vjet.

Kryetari i Partisë Z. Lulzim Basha ka autorizuar publikisht delegimin e të gjithë vendim-marrjes organizative tek dy Nënkryetarët e PDSH dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Zgjedhjet e fundit për Kryetarin e Partisë janë zhvilluar në 22 korrik 2013. Vendimi për mbajtjen e zgjedhjeve respekton këtë afat fundor për kryerjen e zgjedhjeve të radhës me 22 korrik 2017.



Gara dhe votimi për kryetarin e PDSH do të zhvillohen në mënyrë të hapur, të ndershme dhe të barabartë.

Nga ky proces, Partia Demokratike do të dalë më e fortë dhe më demokratike për t'i paraprirë ndryshimeve të mëdha që ka nevojë vendi.

Nënkryetarët e PDSH



Edi Paloka



Edmond Spaho